

**ABDYLAZIS VESELI,  
NJË JETË PËR ARSIMIT SHQIP (1942-2008)**

Dita e 7 Marsit, tanimë e njohur në botën shqiptare si Dita e Mësuesit apo e arsimit shqip, po festohet kudo ku frymon shkolla shqipe, në çdo cep të vendbanimeve të shqiptarëve, kudoqofshin ata, në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Luginë të Preshevës, Mal të Zi dhe në diasporë. Kjo festë, aq e rëndësishme për shqiptarët, që gjithsesi nuk e shënon edhe zanafillën e shkollës shqipe, deri vonë nuk ishte e njohur në përmasat që ka sot. Regjimi komunist i Jugosllavisë i ndalonte këto festa ose i kufizonte në masë të madhe, me arsyetimin se të gjitha shkollat në shtetin e përbashkët duhej ta forconin vëllazërim bashkimin dhe kësisoj nxënësit e mësuesit duhej të festonin data apo ngjarje që në njëfarë mënyre kishin ndonjë lidhje me alfabetin, gjuhën dhe kulturën sllave. Sidoqoftë, sot dëshirojmë që të gjitha ato padrejtësi që i bëheshin shkollës dhe gjuhës sonë, t'i mbeten historisë, por pyetjes se a është e realizuar në tërësi kjo dëshirë, për fat të keq, i përgjigjemi me JO.

Për çdo vit, kjo festë na e freskon kujtesën për historikun e lavdishëm të shkollës shqipe, për mësuesit që flijuan edhe jetën për atdhe për Korçën e shkollës së konsoliduar shqipe. Është normale ta njohim historinë më të largët të arsimit shqip, por paharruar edhe mësuesit e gjeneratave më të vonshme, arsimdashësit që e zhvilluan arsimin shqiptar, nga ai fillestar deri në nivelin e shkollimit universitar. Të atillë, që meritojnë të përkujtohen në këtë ditë të shenjtë për veprën aq të madhe në shërbim të shkollës shqipe, arsimit dhe shkencës, janë shumë. Në mes tyre duhet të përkujtojmë mësuesin veteran, studiuesin këmbëngulës dhe profesorin universitar që u shkollua dhe ushtroi veprimtarinë përveç Kosovës, edhe në Maqedoni e në vende tjera të Jugosllavisë, Abdylazis Veselin, njeriun që nuk mund ta kuptonte jetën pa angazhimin përkushtues në arsim dhe edukim.

Profesor Abdylazizi, edhe pse nuk është më në mesin tonë, jeton në mjediset universitare ku punoi dhe në faqet e një numri të madh librash të botuar prej tij në fushën e arsimit dhe edukimit. Vepra e tij madhështore, me të cilën njësohet emri i prof. Abdylaziz Veselit, flet vetë. Ajo ka mbetur dëshmi dhe shembull për gjeneratat e reja, në mbështetje të punës së tyre sa të vështirë aq edhe të dashur. Gjilani dhe gjilanasit sot identifikohen me emrin e mësuesit të tyre, me pedagogun që u rrit bashkë me shtatin e arsimit në gjuhën shqipe, nga Normalja deri në Universitet. Sot, mësuesit dhe edukatorët e gjithë hapësirave shqiptare të ish- Jugosllavisë, flasin me dashuri për pedagogun dhe profesorin e tyre, për punën e tij me seriozitet dhe përgjegjësi deri në fanatizëm. Këtë personalitet me përmasë aq dimensionale në fushën e arsimit, e përkujtojnë edhe ish- nxënësit e Shkollës Normale. Rrëfimet e tyre për angazhimin e Abdylazizit që të sillte sa më shumë vajza në bankat e shkollës, janë vetëm një segment i kësaj veprimtarie që ndriçonte gjysëmterrën arsimor në këto anë të Kosovës. Për të flasin edhe edukatorët e para shqiptare, të cilat u diplomuan në këtë degë, të vetmen në gjuhën shqipe, që u themelua nga prof. Abdylazizi e që vepronte në kuadër të Shkollës së Lartë Pedagogjike.

Nuk qe e lehtë të formohej ky grup kur mungonin kuadrot dhe kushtet elementare për veprimtarinë e kësaj dege të veçantë. Vetëm me angazhimin e njeriut që arsimin e konsideronte pjesë të jetës dhe ardhmëri të familjes dhe kombit, mund të ndërtohej një qendër e këtillë, e para dhe e vetmja në gjuhën shqipe në tërë hapësirat e ish -Jugosllavisë. Në këto rrethana të reja, thotë në një rast Profesori, Pedagogjia, si shkencë shoqërore, filloi të begatohet me shumë disiplina të reja shkencore, pra edhe me Pedagogjinë Parashkollore, që për herë të parë si lëndë mësimore, u paraqit në Degën e Pedagogjisë së Fakultetit Filozofik të Prishtinës. Në vitin shkollor 1970-1971, me iniciativën e këtij pedagogu, kjo lëndë u fut edhe në Shkollën e Mesme Normale, "Skënderbeu" të Gjilanit, në përgatitjen e edukatoreve parashkollore, ku ai ishte profesor i lëndëve profesionale të mësuesisë. Abdylaziz Veseli ishte njeri i reformave në arsim, ai i përqafoi risitë dhe metodat më bashkëkohore për kohën, ishte aktiv edhe në reformat e vitit 1975, kur shkollat normale u ngritën në nivelin e shkollave të larta,

të njohura edhe si Akademi Pedagogjike. Nga të gjitha qytetet kryesore të Kosovës, ku në kuadër të këtyre Akademive vepronin drejtimet e mësuesisë, vetëm në Gjilan, krahas këtyre drejtimeve, vepronte edhe dega për edukatore të institucioneve parashkollore, e vetmja në tërë hapësirat shqiptare të ish-Jugosllavisë. Kjo arritje për Gjilanin ishte meritë e prof. Abdylazizit, këtij mësuesi të palodhur, që për një kohë të gjatë ishte edhe drejtues i kësaj shkolle.

Abdylaziz Veseli u lind në Gjilan, më 1942, në një familje arsimeve të ardhur nga Medvegja shqiptare. Në qytetin e lindjes mbaroi shkollën fillore dhe gjimnazin, për të vazhduar me punësimin në një shkollë fillore të Gjilanit. Në një periudhë kohore para studimeve, e njohu edhe profesionin e gazetarit, kur punoi një kohë në gazetën "Rilindja", në rubrikën për kulturën. Studimet universitare i kreu në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Shkupit, në grupin e lëndëve pedagogjike. Në vitin shkollor 1963-1964, filloi me punë në Shkollën Normale të Gjilanit, si profesor i Metodikës së Gjuhës Shqipe, i Metodikës së Dituri natyrës dhe Shoqërisë, i Metodikës së Matematikës dhe profesor i Psikologjisë dhe Filozofisë. Gjatë kësaj kohe, ai punoi edhe në gjimnazin, "Zenel Ajdini" të Gjilanit dhe në gjimnazin e porsaormuar të Bujanocit. Meqë Shkolla Normale u ngrit në nivelin e shkollës së lartë, prof. Abdylazizi, kaloi me punë në atë shkollë, ku e fitoi edhe titullin "Ligjërues i shkollës së lartë". Pas një përvoje edhe si drejtor i Shkollës Normale, vendi udhëheqës iu besua edhe në Akademinë Pedagogjike, sic quheshin në atë kohë shkollat e larta, ku u dallua për punën e suksesshme si menaxhues. Edhe pse profesor Abdylazizi krahas veprimtarisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie ushtroi edhe detyra të tjera me interes publik shoqëror, madje në shumë pozita udhëheqëse, asnjëherë nuk u nda nga detyra jetësore e tij, arsimit dhe arsimimi i popullatës shqiptare të Kosovës dhe atyre jashtë saj. Me hapjen e Universitetit të Tetovës në vitin 1994, prof. Abdylazizi, u ftua nga Rektori i parë, prof. Fadil Sulejmani, si ligjërues i lëndëve të fushës së shkencave pedagogjike, për kontributin e të cilit, edhe sot kolegët e tij më të rinj flasin me dashamirësi e respekt të madh.

Studimet e Magjistraturës, që e nxitën më tepër për të ecur drejt hulumtimeve më të thelluara, i kishte filluar që në kohën kur

emri i tij si mësues e pedagog ishte bërë i njohur në veprimtarinë e fushës së arsimit. Në vitin 1978, në Fakultetin Filozofik të Rijekës, me sukses mbrojti punimin shkencor të Magjistraturës me temë: “Studimi i nevojave arsimore dhe kadrovike në Kombinatin e Tekstilit në Gjilan” dhe kështu, krahas këtij titulli të shkencave pedagogjike, mori edhe atë të specialistit të Kuadrologjisë, profesion ky, shumë i nevojshëm për Kosovën e asaj kohe. Nga ky moment, Abdylazizi, e thëllon më tepër veprimtarinë hulumtuese shkencore, duke shkruar një varg punimesh nga fusha e veprimtarisë së tij, që ishin në shërbim të studentëve dhe të shkencës shqiptare në përgjithësi. Kjo veprimtari e tij, kishte për synim edhe titullin akademik të “Doktorit të shkencave”, për t’u ngjitur në majat shkencore të fushës së historisë së shkollës shqipe. Me mbrojtjen e tezës shkencore: “Shkollat dhe arsimi shqip në Kosovë, në Maqedoni, në Sanxhak dhe Mal të Zi në periudhën 1941-1945”, në vitin 1998, në Universitetin e Prishtinës fitoi titullin “Doktor i shkencave të Pedagogjisë”, Abdylaziz Veseli, u dallua nga shumë studiues tjerë, si specialist i historisë së shkollës shqipe i periudhës kur në këto hapësira terri shekullor u zëvendësua me dritën e arsimit, e që konsiderohet edhe fillimi shkollimit në gjuhën amtare, në trojet tona, jashtë kufijve të Shqipërisë së vitit 1913.

Që nga fillimet e veprimtarisë së tij në fushën e arsimit, si mësues i shkollave fillore, si profesor i shkollave të mesme, si ligjërues i shkollës së lartë dhe si profesor universitar, ky arsimdashës nuk iu nda librit dhe dëshirës për të depërtuar në çdo fushë të shkencave pedagogjike. Nga këto njohuri, që përveç studimeve universitare, i fitonte edhe nga hulumtimet e vazhdueshme përmes leximit nëpër bibliotekat e Kosovës, Maqedonisë, të qendrave tjera të ish-Jugosllavisë, e veçmas në Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë dhe bibliotekës së tij personale shumë të pasur, lindën edhe punimet e shumta hulumtuese shkencore, të botuara nëpër revistat e ndryshme që kishin të bëjnë me çështje të arsimit në Kosovë, Shqipëri, Maqedoni etj. Mbi 100 punimet shkencore e profesionale, 14 tekstet me kompetencë të lartë akademike, të fushave të ndryshme, pjesëmarrjet në shumë kongrese, konferenca, simpoziume dhe takime të ndryshme shkencore, janë dëshmi e pamohueshme e veprimtarisë së begatë të këtij personaliteti, që

edhe pse sot nuk është fizikisht në mesin tonë, do të na ndriçojë përjetësisht. Këtë përjetësi të tij e dëshmojnë edhe qindra e mijëra edukatore mësuese, mësues e profesorë, të cilët vazhdimisht e përkujtojnë mësuesin e popullit dhe shkencëtarin këmbëngulës që kombit i dha aq shumë.

Duke mos pasur mundësi që t'i përmendim të gjitha punimet shkencore të profesorit, meqë përmes këtij shkrimi, kemi për qëllim vetëm ta përkujtojmë këtë figurë, që nuk është ndriçuar sa duhet, do i përmendim vetëm librat e botuara sipas kësaj renditjeje kronologjike:

- "Studimi i nevojave arsimore dhe kuadrovice në KT të Gjilanit", 1986.
- "Fjalori shqip-greqisht", 1996 (me bashkautorë).
- "Metodika e njohjes së ambientit", 1987.
- "Leksiku bisedor greqisht-shqip", 1987 (me bashkautorë).
- "Shkolla Normale "Sami Frashëri", 1997 (me bashkautorë).
- "Pedagogjia parashkollore", 1999.
- "Metodika e edukimit parashkollor", 1999.
- "Metodika e mësimit të Dituri Natyrës e Shoqërisë", 2000.

Vepra jetësore e profesor Abdylaziz Veselit, është ajo kushtuar shkollës shqipe në periudhën kohore 1941- 1944, që ishte edhe teza e disertacionit të tij. Kjo vepër kolosale, e përfshirë në gjashtë libra, konsiderohet më e kompletuara deri më tani e kësaj natyre, që në imtësi e ndriçoi rrjetin e shtrirjes së shkollave shqipe në trojet shqiptare, që më vonë mbetën nën Jugosllavi. Kjo vepër, kushtuar veprimtarisë arsimore të një periudhe relativisht të shkurtër kohore, u përfshi brenda këtyre librave:

1. "Shkolla dhe arsimi shqip në Maqedoni gjatë periudhës 1941-1944", libri 1, botuar në vitin 2000, në Tetovë.
2. "Shkolla dhe arsimi shqip në Prefekturën e Prishtinës gjatë periudhës 1941-1944", libri 2, botuar në vitin 2003, në Gjilan.
3. "Shkolla dhe arsimi shqip në Prefekturën e Prizrenit gjatë periudhës 1941-1944", libri 3, botuar në Gjilan.
4. "Shkolla dhe arsimi shqip në Prefekturën e Pejës gjatë periudhës 1941-1944", libri 4, botuar në vitin 2003, në Gjilan.
5. "Shkolla dhe arsimi shqip në Prefekturën e Mitrovicës

gjatë periudhës 1941 -1944”, libri 5, botuar në vitin 2003, në Gjiilan.

6. “Shkollat dhe arsimit shqip në trevat e Ulqinit dhe të Tuzit-nënprefektura të Prefekturës së Shkodrës gjatë periudhës 1941-1944”, libri 6, botuar në vitin 2004, në Gjiilan.

Kjo punë e madhe shkencore e profesorit të nderuar, e bërë me aq thellësi hulumtuese- kërkimore do mbetet burimi kryesor, ku do bazohen të gjithë ata që do merren me shkollën shqipe dhe historinë e saj, sa të dhimbshme aq edhe me arritje. Ai ka nxjerrë në dritë tërë ato dokumente, nga ato më të imtat, që nga regjistri i fëmijëve në foshnjore, e deri te emrat e të gjithë mësuesve të vendit dhe të atyre që emëroheshin nga Ministri i Arsimit të Shqipërisë, intelektuali dhe shkrimtari i madh Ernest Koliqi, i cili me shpërndarjen e qindra mësuesve në tërë trojet shqiptare, kishte qëllim ta përhapte dritën e arsimit edhe në viset e mbuluara nga terri i plotë i padijes dhe analfabetizmit.

Profesor Abdylaziz Veseli, përmes faksimileve të shumë dokumenteve, fotografive të shkollave, nxënësve, mësuesve dhe manifestimeve të shumta, edhe në raste festash kombëtare, përveçse arrinte qëllimin kryesor që ishte vula shkencore, arrinte ta bënte librin edhe tërheqës dhe të lehtë për lexuesin. Ndarja e hershme nga jeta, në vitin 2008, ia ndërpreu profesorit punën e mëtejshme, që me siguri do na sillte prurje të reja në shkencën e pedagogjisë dhe jo vetëm. Ai edhe me kaq, i siguroi vetes përjetësinë, ndërsa gjeneratave kujtesën për njeriun, mësuesin e profesorin që aq shumë bëri për shkollën shqipe.